



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-033

Prishtinë, më 14 shtator 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 SHTATOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Slavko Simiq, Valdete Bajrami dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE: Floriana Shala,
Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një (1) pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 27 korrik 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 27 korrik 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, që kishte kërkuar ta informojë Kuvendin lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015.

Lidhur me kërkesën e kryeministrit për ta informuar Kuvendin, diskutuan: Glauk Konjufca, Donika Kada-Bujupi, Ismet Beqiri, Valdet Bajrami, Adem Grabovci, Aida Dërguti, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 17 shtator 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015,
5. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
8. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
9. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

komuniteti serb.

3. Shqyrtimi i propozimeve, kërkesave dhe njoftimeve:

1. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb, nxori, këtë:

Përfundim

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 17 shtator 2015, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë, si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP Lista serbe, 1 anëtar; GP NISMA, 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, pikën e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

3. Formimi i grupeve të miqësisë

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, e arsyetoi para Kryesisë së Kuvendit në detaje propozimin për formimin e grupeve të miqësisë.

Diskutimi i nënkryetarit të Kuvendit është dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, në parim i miratoi kriteret për ndarjen e grupeve të miqësisë sipas grupeve parlamentare të Kuvendit, ndërsa miratimin e tyre e shtyu për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

4. Njoftimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për dorëheqjen e deputetit Ramush Haradinaj nga Komisioni për Punë të Jashtme

Kryesia u njoftua nga Grupit Parlamentar i AAK-së për dorëheqjen e deputetit Ramush Haradinaj nga Komisioni për Punë të Jashtme.

5. Njoftimi i Komisionit për Punë të Jashtme për vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani dhe Zvicër, prej 16-17 qershor 2015

Kryesia u njoftua nga Komisionit për Punë të Jashtme lidhur për vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani dhe Zvicër, prej 16-17 qershor 2015.

Pika shitesë:

1. Kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, për lejimin e shpenzimeve të derivateve

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se ish-kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, është duke i realizuar përfitimet e ish-zyrtarit të lartë në bazë të Ligjit për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë, me përjashtim të shpenzimeve të derivateve.

Ai tha se ish-kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, ende nuk është duke e realizuar të drejtën në kompensimin e shpenzimeve të derivateve, andaj propozoj që t'i jepen deri në 200 litra derivate në muaj.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Ish-kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë Legjislaturave III dhe IV, z. Jakup Krasniqi, i lejohet shpenzimi i derivateve për veturë në sasi deri në 200 litra në muaj.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 12:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*